

DISA ÇËSHTJE TË FORMIMIT TË ANTONIMEVE FOLJE E NDAJFOLJE NË TERMINOLOGJINË E EKONOMISË NË GJUHËN SHQIPE

Sadete PLLANA

Universiteti i Prishtinës „Hasan Prishtina“, Fakulteti Ekonomik

sadete.pllana@uni-pr.edu

Albulena PLLANA-BREZNICA

Shkolla e mesme teknike „Lutfi Musiqi“, Vushtrri

aalbulena.p@gmail.com

UDC 811.18'373.422

UDC 811.18'276.6:33

Professional paper

Abstract

Based on studies so far, the antonyms have drawn more work than other lexical and generally linguistic microsystems, such as homonyms, synonyms, polysynonyms. Usually, the antonymic words shed light on one another, making their meaning clearer. In this paper, we will treat the antonymic verb and adverb pairs which have a wide use in the terminology of the Albanian language economy. Antonymic relations are, furthermore, important appearances of the systemic character of the language.

As characteristic cases of antonymic pairs in the terminology of the economy, specifically will be treated: bosh-plot (empty-full), duarbosh-duarplot (empty-handed-full-handed), herët-vonë (early-late), lirë-shtrenjtë (cheap-expensive), mbështjell-çmbështjell (wrap-unwrap), pjesërisht-krejtësisht (partially-completely), shtrenjtë-lirë (expensive-cheap), zbrazur-plot (empty-filled) (as characteristic cases of adverbs); bashkoj-veçoj (joint-disjoint), çrregulloj-rregulloj (deregulate-regulate), decentralizoj-centralizoj (decentralize-centralize), doganoj-zhdoganoj (customs-clear), humbas-fitoj (lose-earn), shpenzoj-kursej (spend-save) (as characteristic cases of verbs).

Key words: *Antonyms, economic terminology, adverbs, verb antonyms.*

Përmbledhje

Në bazë të studimeve të deritanishme, antonimet kanë nxjerrë punë më shumë se mikrosistemet e tjera leksikore e përgjithësisht gjuhësore, siç janë homonimet, sinonimet, polisintonimet. Zakonisht, fjalët antonimike hedhin dritë mbi njëra-tjetrën, e bëjnë më të qartë kuptimin e tyre.

Në këtë punim do të trajtohen çiftet antonimike folje e ndajfolje, të cilat kanë një përdorim të gjerë në terminologjinë e ekonomisë në gjuhën shqipe. Marrëdhëniet antonimike janë gjithashtu shfaqje më të rëndësishme të karakterit sistemor të gjuhës. Si raste karakteristike të çifteve antonimike në terminologjinë e ekonomisë trajtohen në veçanti; boshplot, duarbosh-duarplot, herët-vonë, lirë-shtrenjtë, mbështjell-çmbështjell, pjesërisht-krejtësisht, shtrenjtë-lirë, zbratur-plot (si raste karakteristike të ndajfoljeve); bashkoj-veçoj, çrregulloj-rregulloj, decentralizoj-centralizoj, doganoj-zhdoganoj, humbas-fitoj, shpenzoj-kursej (si raste karakteristike të foljeve).

Fjalët kyçe: *Antonimet, terminologjia e ekonomisë, antonimet ndajfolje, antonimet folje.*

Hyrje

Në bazë të studimeve të ndryshme për antoniminë është formuar konkludimi, përveç tjerash, se antonimet janë fjalë me kuptim të kundërt që së pari e pohojnë veten, pastaj e mohojnë fjalën e kundërt.¹ Përkufizimi se antonimet janë çifte fjalësh që kanë kuptime të kundërta, ose janë fjalë me kuptim të kundërt midis tyre, është përkufizim që gjendet në fjalorë², në tekste e në gjuhësinë shqiptare. A do të trajtohet antonimia në kuptim të ngushtë apo të gjerë, varet nga studiuesi dhe prej vet karakterit të tij.

Pa marrë parasysh a është fjala antonimike vetëm a përballë tjetrës që i kundërvihet, ajo është çift, sepse tjetra, edhe nëse nuk është e pranishme, ajo nënkuptohet nëpërmjet asociacionesh psikolinguistike në ndërgjegjen e përdoruesit, gjegjësisht folësit. Kështu që, sa

¹ M. Samara, “Mbi karakterin antonimik të kuptimeve të fjalëve në gjuhën shqipe” në “Studime mbi leksikun”, II, Tiranë, 1972, fq. 144.

² Fjalor i gjuhës shqipe, Tiranë, 1954, f. 13; Fjalor i gjuhës së sotme shqipe, Tiranë, 1980, fq. 41.

herë të figurojë a të dëgjohet fjala natë, na përkujtohet fjala ditë. Kështu ndodh edhe me fjalë të tjera, p.sh. Aftësi-paafhtësi, dashuri-urrejtje, akordim-çakordim etj.

Gjithashtu ndodh edhe me antonimet ndajfolje, të cilat përdoren në terminologjinë ekonomike në gjuhën shqipe: bosh-plot, krejtësisht-pjesërisht, lirë-shtrenjtë, pak-shumë, shpesh-rrallë, shtrenjtë-lirë etj. Në vazhdim do të japim disa shembuj të çifteve antonimike, folje, të cilat gjithashtu kanë një përdorim të gjerë në terminologjinë ekonomike në gjuhën shqipe: blokoj-zhblokoj, rregulloj-çrregulloj, doganoj-zhdoganoj, gradoj-zhgradoj, shpenzoj-kursej, vlerësoj- zhvlerësoj etj.

Në të gjitha çiftet antonimike të lartpërmendura, karakteri i kundërt i kuptimeve ose kundërvënia e tyre i lidh aq ngushtë fjalët antonime me njëra-tjetrën sa që çdonjëra prej tyre duket sikur nuk mund të kuptohet fare pa tjetrën. Kuptimi i dhënë dhe veprimi i shënuar, p.sh. nga foljet: centralizoj, rregulloj, shes, shpenzoj, zhblokoj ose kuptimi dhe tipari i shënuar nga ndajfoljet: duarplot, rrallë, plot, shtrenjtë pa përmbajtjen e gjymtyrës tjetër të çiftit (përkatësisht decentralizoj, çrregulloj, blej, kursej, blokoj); (duarbosh, jorrallë, zbrazur, lirë) duket sikur nuk mund të ekzistonte, prandaj edhe shpjegimi i njërit kuptim bëhet duke iu kundërvënë tjetrit.

Lidhjet midis antonimisë e mohimit

Lidhur me përcaktimin e drejtë të këtyre ose atyre fjalëve si antonime, është e nevojshme të sqarohen mirë lidhjet midis antonimisë e mohimit, meqenëse në çdo çift antonimik kuptimi i kundërt i njëres prej gjymtyrëve të tij përmban në vetvete edhe elemente mohimi të kuptimit të gjymtyrës tjetër në atë çift. Mohimi antonimik, si një mohim gjuhësor lidhet me mohimin logjik dhe atë dialektik, por nuk duhet vënë shenja e barazimit midis tyre.

Mohimi antonimik është një karakteristikë mjaft e përgjithshme e fjalëve që kundërvihen; ai hyn ose është në përmbajtjen e fjalëve a të njësive frazeologjike antonime si pjesë e brendshme e tyre; në këtë kuptim mund të themi se ndajfolja shpejt e mohon ndajfoljen avash; folja forcoj mohon foljen dobësoj. Po kështu, edhe kuptimi pohues i njëres fjalë lidhet me kuptimin e kundërt të fjalës që e mohon të parin.

Fjalët antonime me rrënjë të ndryshme

Duke analizuar çiftet antonimike të fjalëve: shpejtësi-ngadalësi, shumicë-pakicë, shtrenjtësi-lirësi, shpenzoj-kursej etj., kuptimet e kundërta shprehen strukturalisht me fjalë që kanë kompleks fonetik krejt të ndryshëm, prandaj edhe karakteri antonimik i kuptimeve të

fjalëve nga pamja e jashtme nuk lë hapësirë për asnjë dyshim; antonimia e tyre është e mirëfilltë si nga ana semantike ashtu edhe strukturore.

Kështu, antonimia e fjalëve me rrënjë të ndryshme përbën tipin strukturor më klasik jo vetëm në gjuhën shqipe, por edhe në të gjitha gjuhët e tjera të familjes indoevropiane. Fjalët antonime me rrënjë të ndryshme mund të kenë jo vetëm rrënjë, por edhe tema tërësisht të ndryshme. Në çiftet antonimike: ditë-natë, pak-shumë, hyj-dal etj. Rrënjët e ndryshme të fjalëve antonime përputhen me temat e tyre; ato përbëhen vetëm nga një morfemë fjalëformuese; kurse në çiftet: shtrenjtësi-lirësi, shpejtësi-ngadalësi, shpeshtim-rrallim, mohim-pohim, përmbrenda-përrjashta, ribashkoj-rindaj, ripohoj-rimohoj, etj.

Fjalët antonime përbëhen nga më shumë se një morfemë, sepse kanë edhe prapashtesat: -si, -im ose parashtesat: për- e ri-, të cilat janë në çift të njëjta, si nga ana morfematike ashtu edhe nga ana funksionale.

Çiftet antonimike ndajfolje e folje

Në vazhdim do të paraqesim çiftet antonimike **ndajfolje**, të cilat gjejmë përdorim në terminologjinë e ekonomisë: andejpari-kendejpari, armiqësisht-miqësisht, asnjëherë-kurdoherë, atje-këtu, avash-shpejt, bosh-plot, brenda-jashtë, çift-tek, dendur-rrallë, ditën-natën, djathtas-majtas, dje-sot, drejt-shtrembër, drejtpërdrejt-tërthorazi, duarbosh-duarplot, fshehtas-haptas, gjatë-shkurt, gjerësisht-hollësisht, gjithkund-asgjëkund, gjithnjë-rrallë, hapur-fshehur, herët-vonë, hollë-trashë, jorrallë-rrallë, joshpesh-shpesh, këtejpari-andejpari, këtu-atje, krejtësisht-pjesërisht, kurdoherë-asnjëherë, lirë-shtrenjtë, lodh-çlodh, majtas-djathtas, mbështjell-çmbështjell, mirë-keq, nesër-dje, ngadalë-shpejt, pak-shumë, përmbrenda-përrjashta, pjesërisht-krejtësisht, rastësisht-jorastësisht, rrallë-shpesh, rrallëherë-shpeshherë, shkurt-gjatë, shpejt-mgadalë, shpesh-rrallë, shtrenjtë-lirë, shtrirë-mbledhur, shumë-pak, tek-çift, thatë-lagët, ulur-çuar, vertikalisht-horizontalisht, zbrazur-plot etj.

Çiftet antonimike folje, të cilat gjejmë përdorim në terminologjinë e ekonomisë: akordoj-çakordoj, bashkoj-veçoj, bëj-zhbëj, bie-çoj, blej-shes, blokoj-zhblokoj, çakordoj-akordoj, çel-mbyll, çekuilibroj-ekuilibroj, çmat-mat, çbush-mbush, çmobilizoj-mobilizoj, çorientoj-orientoj, çrregulloj-rregulloj, decentralizoj-centralizoj, dezinformoj-informoj, doganoj-zhdoganoj, drejtoj-shtrembëroj, ekuilibroj-çekuilibroj, emëroj-çemëroj, fut-nxjerr, godit-kundërgodit, gradoj-zhgradoj, heq-shtie, vë (fut), humbas-fitoj, informoj-dezinformoj, inkurajoj-dekurajoj, jap-marr, keqësoj-mirësoj, kurdis-shkurdis, kursej-shpenztoj, kyç-hap, largoj-afroj, lejoj-ndaloj, lidh-zgjdh, marr-jap, mat-çmat, mbaroj-filloj, mbuloj-zbuloj, mbyll-hap, mirëkuptoj-keqkuptoj, mobilizoj-çmobilizoj, ndaloj-lejoj, ndot-pastroj, nënvlerësoj-

mbivlerësoj, ngarkoj-shkarkoj, orientoj-çorientoj, paketoj-shpaketoj, pengoj-shpengoj, përqëndroj-shpërqëndroj, qetësoj-shqetësoj, radhit-çradhit, ribashkoj-rindaj, ripohoj-rimohoj, rralloj-shpeshtoj, rregulloj-çrregulloj, sulmoj-kundërsulmoj, shes-blej, shkurtoj-zgjat, shpenzoj-kursej, shpeshtoj-rralloj, shpërqëndroj-përqëndroj, trash-holloj, veçoj-bashkoj, vështirësoj-lehtësoj, zbuloj-mbuloj, zgjat-shkurtoj, zgjeroj-ngushtoj, zhdëmtoj-dëmtoj, zhgradoj-gradoj, zhvesh-vesh, zhvlerësoj-vlerësoj etj.

Përfundim

Antonimet, ashtu sikurse sinonimet, janë gjymtyrë të një grupi a vargu tematik ose elemente të një fushe semantike, por të lidhura nga karakteri i kundërt i kuptimeve të tyre; ato kanë cilësinë të qëndrojnë zakonisht afër njëra-tjetrës; ato rrënjosen në ndërgjegjien e atij që flet ose shkruan si çifte fjalësh, të cilat mund të zëvendësojnë njëra-tjetrën në të njëjtin kontekst sintaksor. Në themel të antonimisë qëndron kundërvënia semantike e fjalëve, prandaj nganjëherë ajo quhet edhe antonimi leksikore, për ta dalluar nga antonimia gramatikore stilistikore dhe e njërive frazeologjike. Zakonisht, fjalët antonimike hedhin dritë mbi njëra-tjetrën, e bëjnë më të qartë kuptimin e tyre.

Karakteri sistemor i lidhjeve antonimike duket edhe në një nga tiparet gjuhësore më të rëndësishme të kuptimeve antonimike, në sferën e njëjtë ose të ngjashme të togfjalësimit leksikor, që është rezultat i asaj që këto nocione të kundërta lidhen me njëri-tjetrin nga pikëpamja logjiko-sendore. Antonimet aktive e pasive bashkohen po me të njëjtin rreth fjalësh bilanc e saldo. Antonimia, pra, ndryshe nga dy dukuritë e tjera, shumëkuptimësia dhe sinonimia karakterizohen pozitivisht në terminologji; ajo dëshmon për lidhje sistimore të nocioneve e për një terminologji të zhvilluar në sistem.

Kur antonimet janë folje, përgjithësisht, ato kanë të njëjtën diatezë; diateza mund të ndërrojë në raste të rralla, si: bie (jokal.)-çohem (vetv.) etj. Si pjesë të pandryshueshme të ligjëratës kemi fjalë antonime që vijnë nga pjesë të pandryshueshme; parafjalë prej ndajfoljesh: afër-larg, brenda-jashtë, sipër-poshtë etj.; ndajfolje prej emrash: vjet-mot, natë-ditë dhe ndajfolje prej foljesh me anë të ndajfoljërimit të pjesoreve: hapur-fshehur, shtrirë-mbledhur, ku pjesoret e foljeve përdoren si ndajfolje me funksionin e rrethanorëve të mënyrës.

Bibliografia

Dhrimo, A. & Memushaj, R. (2011). “Fjalor drejtshkrimor i gjuhës shqipe” , INFBOTUES, Tiranë.

Duro, A. (2009). “Termi dhe fjala në gjuhën shqipe” IGJL, Fan Noli, Tiranë.

Fjalor i termave të transportit shqip-anglisht-frëngjisht-rusisht (2002) , ASHSH, IGJL, Tiranë.

Gorani, H. (2009). “Problemet kuptimore në terminologjinë ekonomike” në Gjendja dhe zhvillimi i terminologjisë shqipe, probleme e detyra” , ASHSH&ASHAK, Tiranë.

Memushaj, R. (2004). “Hyrje në gjuhësi” , DITURIA, Tiranë.

Pllana, S.; Çitaku, F.; Arifaj, S.; Pllana, G. (2011). “PROBLEM OF ANTONYMS IN THE MECHANICS TECHNOLOGY IN ALBANIAN AND ENGLISH”, SUT Scintific Observer, Academic and scientific journal of linguistics, literature, education and culture published annually by the department of English language and literature State University of Tetova, Vol. 1, Issues 2&3.

Pllana, S.; Pllana, G. (2014). “ABOUT SOME MANIFESTATIONS OF ANTONYMY AND SYNONYMY IN THE TERMINOLOGY OF ECONOMICS”, Mediterranean Journal of Social Sciences MCSER Publishing, Rome-Italy, Vol. 5, No. 13, June 2014.

Rexha, N. (2009). “Fjalor i biznesit, ekonomikës dhe finances anglisht-shqip, shqip-anglisht”, ASAU, Prishtinë.

Sager, J. (1990). “A practical course in Terminology Processing”, Amsterdam, Philadelphia: John Benjamins.

Samara, M. (1985).” Çështje të antonimisë në gjuhën shqipe”, ASHSH, Tiranë.

Samara, M. (1999). “Fjalor i antonimeve në gjuhën shqipe”, ASHSH, IGJL, Tiranë.

Thomaj, J. (2006). “Leksikologjia e gjuhës shqipe”, BOTIMET TOENA, Tiranë.